



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA FIER

Nr. \_\_\_\_prot.

Fier, me \_\_\_\_ .2024

Procesverbal

“Mbi argumentimin e specifikimeve teknike për blerjen “Shërbim për transportin e ushqimeve për nevoja të QEA-së,për vitin 2025”

- ❖ **Mjeti të jetë i mbyllur me kushte të përshtatshme (frigoriferike ATV) për transportin e ushqimeve të freskëta si mish, qumësht, fruta, perime etj.** Për hartimin e specifikimeve teknike të mjetit frigoriferikë, grupi I punës është referuar specifikave respektive në raport me natyrën e aktivitetit që mjeti do të kryej, kapacitetin e mallrave që duhet të transportoj çdo ditë në institucionet në varësi të QEA .
- ❖ **Mjeti të jetë i pajisur me leje nga bashkia për transport mallrash.** Ky specifikim teknik është vendosur duke patur parasysh se ky automjet do të jetë në shërbim të AK në destinacione të përcaktuara për shpërndarje produktesh ushqimore në sasi të vogël dhe të madhe për të përballuar furnizimin e çerdheve dhe kopshteve me frekuentim të ulët në distanca të largëta, duke krijuar kështu lehtësi në transport dhe patjetër mjeti duhet të jetë i pajisur me leje për transport mallrash sipas legjislacionit në fuqi. Bazuar në Udhëzimin nr.15 date 24.07.2007 i ndryshuar “Per kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” nëse mjeti është me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohet për transport mallrash.
- ❖ **Të jetë i pajisur me leje qarkullimi për vitit 2024 - 2025. Duke u bazuar në Ligjin Nr. .8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor I Republikës së Shqipërisë” I përditësuar.** Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Leja e qarkullimit nuk mund të lëshohet kur nuk plotësohen kërkesat për kryerjen e shërbimit ose transportit sipas destinacionit, kur këto kërkojnë nga dispozitat ligjore.
- ❖ **Të ketë akt kolaudimin e makinës.** Ky specifikim është kërkuar dispozitave të Ligjit Nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor I Republikës së Shqipërisë” I përditësuar, **neni 79:** Drejtuesi i mjetit është i detyruar të kontrollojë gjendjen teknike të mjetit para nisjes dhe gjatë udhëtimit për të shmangur aksidentet e mundshme. Qarkullimi i mjetit me të meta teknike ndëshkohet me masë administrative me gjobë sipas pikës 5 të nenit 71.
- ❖ **Të ketë paguar taksën e shfrytëzimit të automjetit.**
- ❖ **Të ketë paguar siguracionin për vitin 2024 – 2025, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi (Ligjin Nr. 32/2021 “Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”, Neni 4 Detyrimi për t’u siguruar:**  
Pronari i çdo mjeti transporti përpara përdorimit të mjetit është i detyruar të lidhë njëkontratë sigurimi sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim.

- **Të jetë mjet transporti frigoriferik i mbyllur me kapacitet mbajtës jo më pak se 800 kg, për arsye se ushqimet do të transportohen çdo ditë nga e hëna deri të premtën në konvikt, në Shkollën “Horizot”, 10 kopshte (përfshirë edhe kopshtin Rom) dhe 4 çerdhe të qytetit të Fierit dhe ka një sasi të konsiderueshme të ushqimeve të cilat transportohen çdo ditë.**
- ❖ **Mjeti të jetë pajisur me leje higjieno sanitare nga organet kompetente të ngarkuara sipas ligjit Nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektoriatin sanitar shtetëror”,**
- ❖ **Drejtuesi i mjetit të jetë i pajisur me leje higjieno sanitare nga organet kompetente të ngarkuara me ligj. Pajisja është e detyruar për të gjithë personat duke zbatuar nenin 17 të ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” I ndryshur, Nën mbikëqyrje shëndetësore, për parandalimin e sëmundjeve infektive, vihen personat që:**
  - a) punojnë në prodhimin dhe tregtimin e artikujve ushqimorë apo që punojnë në furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm, të cilët, në punët dhe detyrat e tyre të punës, vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë me artikujt ushqimorë, përfshirë ujin e pijshëm;
  - b)shërbejnë në institucionet shkollore dhe parashkollore, çerdhe dhe kopshte;

## **GRUPI I PUNËS**